

# TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME - TKP

## Ndryshimet e dates se rezervimit dhe anulimet

1. Ndryshimi i dates se rezervimit mund te behet me se voni 48 orë para nisjes se fluturimit ( qoftë segmenti I nisjes apo I kthimit ). Ndryshimi behet sipas differences se çmimit me te cilin eshte bere paraprakisht rezervimi – segmenti I caktuar I cili kerkohej te ndryshohet dhe çmimi ne daten kur kerkohej te behet ndryshimi ( nese ka ndonje diference ajo kalkulohej automatikisht nga sistemi , ose ne rastin kur nuk ka nuk ngarkohet me pagese shtese )
2. Ndryshimi i emrit te pasagjerit mund te behet me se voni 1 orë para kohes se nisjes se fluturimit ( kjo vlene vetem per biletat njedrejtimshe , perderisa te biletat kthyesse emri apo mbiemri mund te ndryshohet vetem para shfrytezimit te segmentit te pare - nisjes e asesi ne segmentin e kthimit ) Çdo ndryshim emri apo mbiemri mund te behet duke paguar diferencen ne mes te çmimit me te cilin eshte rezervuar dhe çmimit aktual ( nese ka nje diference te tille ) As ne kete rast nuk aplikohet ndonje shume fikse , paushall , perveq differences se çmimit. ( I vetmi rast kur perjashtohet pagesa e differences se çmimit ne rast ndryshimi emri apo mbiemri eshte kur behet permiresimi i me se shumti 3 shkronjave )
3. Ne rastin kur bileta-rezervimi eshte kthyesse dhe segmenti I nisjes shfrytezohej atehere segmenti i kthimit nuk refundohet , por bileta - segmenti i kthimit i mundesohet pasagjerit ta shfrytezoj ne nje periudhe deri 6 muaj. Kuptohet vetem i njeiti pasagjer mund ta shfrytezoj kthimin. Kjo mundesohet nese pasagjeri njofton me se voni 48 ore para nisjes se fluturimit , gjegjesisht segmentit te kthimit . Rezervimi (segmenti I kthimit) si çdo ndryshim date edhe ne kete rast behet me pagese shtese nese ka diference nga çmimi I atij segmenti ne daten kur ka qene e rezervuar me çmimin e dates se caktuar kur pasagjeri vendose te udhetoje.
4. Ne rastin kur pasagjeri mungon apo nuk e shfrytezoj segmentin e nisjes ( tek bileta kthyesse ) segmenti I kthimit refundohet ( rimbursohet ) , por kjo eshte e mundur vetem nese segmenti I dyte apo I kthimit eshte se paku 48h pas atij te nisjes dhe lajmerohet me kohe si rast per te pasur mundesi te procedohet me refundimin e kthimit.

## Anulimet e rezervimeve

Anulimi I rezervimit ( pa ndonje ndalesse apo demshperblim) mund te behet me se voni 72 ore para kohes se nisjes se fluturimit perkates ( perveq rasti si n epiken shtese ne vijim ),por kjo vlene vetem per rezervimet te cilat nuk kane qendruar me gjate se 10 dite ne system, Ketu aplikohen shkallet e demshperblimit si ne vijim:

1. Nga 72 deri 48 orë para fluturimit: 50.00 EUR / 50 SFR për çdo pasagjer nga segmenti nisjes
2. Nga 48 deri 24 orë para fluturimit: 100.00 EUR / 100 SFR për çdo pasagjer nga segmenti nisjes
3. Më pak se 24 orë para fluturimit: 100% të çmimit të segmentit te nisjes

## Pika shtese per anulime

Per rezervimet te cilat kane qendruar per kohe me te gjate ne system konkretisht minimum 10 dite pune ( ketu vetem e dielja nuk logaritet dite pune ) apo më tepër ditë atehere aplikohen shkallet e ndaleses apo demshperblimit si ne vijim:

1. Me shume se 72 orë para fluturimit: 50.00 EUR / 50 SFR për çdo pasagjer nga segmenti nisjes
2. Nga 72 deri 48 orë para fluturimit: 100 EUR / 100 SFR për çdo pasagjer nga segmenti nisjes
3. Nga 48 deri 24 orë para fluturimit: 200 EUR / 200SFr për çdo pasagjer nga segmenti nisjes
4. Më pak se 24 orë para fluturimit: 100% të çmimit të biletës te segmentit nisjes

Çdo rezervim mund te anulohet brenda 2 oresh nese fluturimi eshte jo me afer se 24 orë , perndryshe me se voni 1 ore pas rezervimit ne rastin kur fluturimi eshte jo me afer se 12 orë.

Ne rast kur ka INAD ( nje pasagjerit te cilit nuk I lejohet hyrja ne shtetin – destinacionin e tij ) per çfardo arsye e te cilin e kthen policia kufitare e atij shteti , pergjegjesine dhe demin qe rezulton nga “ INAD “ e merr persiper dhe e barte agjensioni I cili e ka bere rezervimin , perjashtohet rasti kur bileta eshte bere qe ne fillim kthyses .

## **Çmimet e publikuara ne sistem [www.flyprn.com](http://www.flyprn.com)**

Të gjitha çmimet e publikuara ne system jane momentale dhe mund te ndryshojne varesisht nga shitja ( kerkesa ) sipas klasave per te cilat ne nuk mbajme pergjegjesi per rritjen e çmimit . Perndryshe te gjitha çmimet jane NETO . Gjithashtu çmimet si nje drejtim ashtu edhe kthyses jane te njejta si per te rritur (ADL ) ashtu edhe per femije ( CHD ) nuk ka ndonje dallim.

Sqarim: Gjate procesit te rezervimit ka raste , sidomos kur jane me teper se 1 pasagjer , 2,3,4 apo 5 qe per ndonjerin pasagjer rritet çmimi ( klasa ) edhepse jane ne te njejtin rezervim , keshtuqe ju preferojme qe para se te ofroni çmimin per pasagjer ta shikoni sa kushton per komplet sa pasagjere jane per te evituar ndonje rast te tille, perndryshe nuk ka mundesi te permiresimit te çmimit ne rast te ngritjes.

Per raste urgjente apo te veçanta mund te kontaktoni ne numrat tane kontaktues:

Kosove: +383 45 338 666

Ju lutemi te keni parasysh qe keto rregulla hyjne ne fuqi dhe do te jene plotesisht te zbatueshme nga data **15.10.2020** .

Me respekt,

**FLY PRISHTINA Shpk.**